



TË MËRKURËN KA NISUR ZYRTARISHT FUSHATA PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME
PARLAMENTARE TË 28 DHJETORIT

ZYRTARISHT NIS FUSHATA ZGJEDHORE, PARTITË ME PREMTIME TË REJA



Të mërkurën ka nisur zyrtarisht fushata për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit, e cila do të zgjasë deri më 28 dhjetor në orën 06:59. Gjatë kësaj periudhe, subjektet politike kanë të drejtë të organizojnë tubime,

ngjarje politike, debate, konferenca për media dhe aktivitete të ngjashme. Në hapjen e fushatës zgjedhore, liderët e partive politike kanë dhënë premtime të reja para qytetarëve me rastin e prezantimit të programeve të tyre qeverisëse

**KOSOVA NËNSHKRUAN
UJDI PËR BLERJEN
E SISTEMEVE TË
ARTILERISË HUMVEE
HAWKEYE NGA
PRODHUESI AMERIKAN**

F. 3



**SUPREMJA ANULON
VENDIMIN PËR
SHKARKIMIN E
KELMENDIT NGA
USHTRUESI I DETYRËS
SË KRYEPROKUROR TË
SHTETIT**

F. 7



RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**I DYSHUARI PËR SULMIN NË
PLAZHIN AUSTRALIAN AKUZOHE
PËR 59 VEPRA PENALE**

F. 2

**ÇFARË PRITET NGA SAMITI
BE-BALLKANI PERËNDIMOR?**

F. 5

**PËRUROHEN AKSELERATORI
I RI DHE BUNKERI NË KLINIKËN
E ONKOLOGJISË, INVESTIM PREJ
2.7 MILIONË EURO**

F. 6

EKONOMI



**NGA ELEKTRONIKA TEK USHQIMI:
KOSOVA SHPENZOI GATI 900
MILIONË EURO PËR MALL KINEZ**

F. 8

**NË KOSOVË VENDOSEN MASA
MBROJTËSE PËR NAFTËN**

F. 7

SPORT



**FIFA: 10 MILIONË EURO SHPËRBLIM
PËR KOSOVËN E SHOIPËRINË NËSE
KUALIFIKOHEN NË KUPËN E BOTËS**

F. 11

I DYSHUARI PËR SULMIN NË PLAZHIN AUSTRALIAN AKUZOHEP PËR 59 VEPRA PENALE

SIDNEJ, 17 DHJETOR - Tri ditë pas sulmit vdekjeprurës në plazhin Bondi Sidnejt, autoritetet australiane kanë ngritur aktakuzë ndaj një të dyshuari 24-vjeçar për 59 vepra penale, përfshirë 15 akuza për vrasje. Në një komunikatë të mërkurën, Ekipi i Përbashkët Kundër Terrorizmit i Uellsit të Ri Jugor (JCTT) njoftoi se oficerët shkuan në spital, ku i dyshuari u akuzua zyrtarisht për 15 vepra penale të vrasjes dhe 40 vepra penale të shkakimit të dëmtimeve të rënda trupore me qëllim vrasjeje. Akuzu të tjera përfshijnë përdorimin e armës së zjarrit me qëllim shkakimin e dëmtimeve të rënda trupore dhe shfaqjen publike të simboleve të një organizate të ndaluar terroriste. Naveed Akram dhe babai i tij, Sajid Akram, akuzohen se hapën zjarr ndaj turmës se njerëzve që po festonin festën hebraike të Hanukës në plazh të dielën, duke vrarë i 15 njerëz dhe duke plagosur dhjetëra të tjerë. Babai 50-vjeçar u vra nga policia në vendngjarje, ndërsa djali i tij u arrestua dhe u dërgua në spital në rrezik për jetën pasi u plagos

rëndë.

Naveed Akram doli nga koma të martën. Sipas gazetës The Sydney Morning Herald, 24-vjeçari nuk pranoi të japë deklaratë.

Autoritetet thanë se 20 njerëz të plagosur janë ende duke u trajtuar në spital. Pesë prej tyre janë në gjendje kritike.

Lidhje të mëparshme me Shtetin Islamik

Autoritetet thonë se sulmuesit kishin lidhje me organizatën terroriste Shteti Islamik. Sipas zyrtarëve, disa pajisje shpërthyesë dhe dy flamuj të improvizuar të Shtetit Islamik u gjetën në makinën e djalit.

Kryeministri australian, Anthony Albanese, theksoi se agjencia e inteligjencës së brendshme e kishte hetuar të riun, asokohe adoleshent, gjashtë vjet më parë për lidhje të dyshuara me një qelizë terroriste të Shtetit Islamik në Sidnej. “Duhet të rikthehemi dhe të shohim se çfarë ndodhi në vitin 2019, kur ky person u hetua, dhe çfarë vlerësimi u bë”, tha



Albanese për ABC Newsradio të mërkurën.

Ai shtoi se gjithçka duhet të rishikohet, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve të inteligjencës, agjencive të sigurisë dhe policisë.

Dy sulmuesit kishin kaluar një muaj në Filipine pak para sulmit, ku, sipas raportimeve të mediave australiane, kishin marrë trajnim “të stilit ushtarak” në ishullin Mindanao. Shteti Islamik është aktiv në Filipine përmes grupeve

lokale xhihadiste.

Sipas autoriteteve të emigracionit në Manila, babai ishte me origjinë nga India dhe kishte leje të qëndrimit të përhershëm në Australi, ndërsa djali është i lindur në Australi.

UKRAINA NË RREZIK TË KOLAPSET FINANCIAR, VON DER LEYEN PROPOZON DY OPSIONE PËR MBËSHTETJE NGA BE



BRUKSEL, 17 DHJETOR - Presidentja e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen, ka propozuar dy opsione për financimin e Ukrainës gjatë periudhës 2024-2025, një të bazuar në përdorimin e aseteve dhe një tjetër nëpërmjet huave të Bashkimit Europian.

Sipas mediave ajo theksoi se është e nevojshme që Këshilli Europian të marrë një vendim të qartë mbi këtë çështje në takimin e ardhshëm.

Gjatë fjalimit të saj në seancën plenare të Parlamentit Europian në Strasburg, më 17 dhjetor, von der Leyen shpjegoi se fondet aktuale për Ukrainën pritet të përfundojnë në prill,

duke krijuar një mungesë financiare totale prej 135 miliardë euro për vitet 2026-2027.

Ajo shtoi se Bashkimi Europian ka ndërmend të mbulojë dy të tretat e kësaj shume, ose ndryshe 90 miliardë euro.

Një nga propozimet më të diskutueshme është përdorimi i aseteve ruse të sekuestruara, që mund të shfrytëzohen për të mbështetur Ukrainën.

Ky propozim, që arrin në 185 miliardë euro, është kundërshtuar nga disa shtete të BE-së, përfshirë Belgjikën, Italinë, Bullgarinë, Maltën dhe Çekinë, të cilat kërkojnë alternativa financiare, përfshirë

borxhe të përbashkëta.

Belgjika ka kërkuar që rreziqet ligjore dhe financiare të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet shteteve anëtare.

Nga ana tjetër, Hungaria, e udhëhequr nga Viktor Orbán, ka bllokuar çdo mundësi për financim të mëtejshëm për Ukrainën.

Megjithëse huaja mund të miratohet me shumicë të kualifikuar (15 nga 27 vendet e BE-së), BE-ja nuk po konsideron të shkojë përpara pa mbështetjen e Belgjikës.

Një takim i të dërguarve të BE-së të martën, 16 dhjetor, në Bruksel nuk dha përparim të dukshëm, sipas diplomatëve.

Zbulim shkencor i veçantë, gjenden mijëra gjurmë dinozaurësh në Italinë Veriore

MILANO, 17 DHJETOR - Një zbulim spektakolar ka ndodhur në një nga parkun kombëtar Stelvio në Italinë veriore, ku janë gjetur mijëra gjurmë të dinozaurëve që datojnë rreth 210 milionë vjet më parë. Këto gjurmë të shumta, që ndodhen në një mur malor vertikal, janë një dëshmi e

jashtëzakonshme e jetës dhe ecjes së këtyre krijesave prehistorike gjatë periudhës Triasike. Shkencëtarët e kanë quajtur këtë zbulim një “thesar shkencor”, pasi ofron një pasqyrë të pastër të sjelljes dhe lëvizjeve të dinozaurëve të lashtë.

Gjurmët, disa prej të cilave kanë

një diametër deri në 40 cm, janë të dukshme për detaje të jashtëzakonshme. Shumë prej tyre tregojnë qartë gjurmët e gishta dhe kthetrat e këmbëve, duke ofruar një pamje të qartë të lëvizjes së dinozaurëve. Ato janë të rreshtuara në rreshta paralele, çka sugjeron që dinozaurët

mund të kenë lëvizur në grupe ose tufa.

Sipas paleontologut Cristiano Dal Sasso, i cili është bazuar në Milano dhe ka udhëhequr pjesën më të madhe të kërkimeve, gjurmët e gjetura i përkasin një grupi dinozaurësh të njohur si prosauropodë,

krijesa barngrënëse me qafa të gjata dhe koka të vogla.

Këta dinozaurë mund të kenë arritur deri në 10 metra gjatësi dhe ecnin mbi dy këmbë, ndonëse disa gjurmë tregojnë përdorimin e duarve të tyre për të mbështetur trupin kur ndaloheshin.

KOSOVA NËNSHKRUAN UJDI PËR BLERJEN E SISTEMEVE TË ARTILERISË HUMVEE HAWKEYE NGA PRODHUESI AMERIKAN

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) do të pajiset gjithashtu me ambulanca, kamionë komandimi dhe kontrolli, si dhe kamionë të tjerë mbështetës, të cilët mundësojnë funksionimin e një baterie të plotë artilerie dhe vendosjen e kapaciteteve të qitjes indirekte, sipas kontratës trevjeçare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Kosova ka nënshkruar marrëveshje me prodhuesin amerikan të industrisë ushtarake, AM General, për blerjen e sistemeve moderne të artilerisë së lëvizshme, HUMVEE Hawkeye 105mm, njoftoi të mërkurën ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

Në një shkrim në “Facebook”, Maqedonci theksoi se “me këtë blerje, ushtria jonë po kalon në një fazë tjetër zhvillimi, atë të rritjes së fuqisë së zjarrit direkt për qitje në distanca të largëta”. Ai e vlerësoi marrëveshjen si hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës dhe për ndërtimin e një ushtrie moderne, të aftë, të gatshme dhe ndërvepruese me aleatët strategjikë të vendit. Prodhuesi amerikan tha në një njoftim në uebsajtin e vet se Kosova pritet t'i pranojë sistemet e para brenda dy

vjetëve të ardhshme.

Përveç sistemeve të artilerisë lëvizëse HUMAVEE Hawkeye, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) do të pajiset gjithashtu me ambulanca, kamionë komandimi dhe kontrolli, si dhe kamionë të tjerë mbështetës, të cilët mundësojnë funksionimin e një baterie të plotë artilerie dhe vendosjen e kapaciteteve të qitjes indirekte, sipas kontratës trevjeçare. “Jemi krenarë të njoftojmë shitjen e suksesshme të HUMVEE Hawkeye Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, një dëshmi e përkushtimit tonë për të ofruar zgjidhje të avancuara për nevojat moderne ushtarake”, tha John Chadbourne, zëvendëspresident ekzekutiv për Zhvillim Biznesi në AM General.

HUMVEE Hawkeye është i pajisur me teknologjinë Soft Recoil, e cila mundëson integrimin e një topi 105 mm



mbi platformën e fortë dhe të dëshmuar në fushëbetejë HUMVEE. Kjo lejon vendosjen, qitjen dhe zhvendosjen e sistemit në më pak se 90 sekonda, duke rritur mbijetesën ndaj zjarrit kundërbaterik krahasuar me sistemet e tërhequra tradicionale. Vitet e fundit Kosova e ka përsheptuar armatosjen, duke blerë armë kryesisht nga Shtetet e Bashkuara edhe nga Turqia, përfshirë raketa dhe dronë.

Kjo nuk është hera e parë që ajo nënshkruan kontratë me AM General, pasi më 2018, në Kosovë mbërritën 51 automjete ushtarake amerikane, të tipit Humvee.

Kosova është në proces të shndërrimit të FSK-së në ushtri. Përpjekja nisi më 2018 dhe pritet të zgjasë dhjetë vjet. Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur nga fillimi shndërrimin e FSK-së në ushtri, por jo edhe NATO-ja, e cila ngul

këmbë që FSK-ja t'u përmbahet detyrave të saj fillestare, si: reagimi ndaj krizave apo mbrojtja civile

Kosova po ashtu synon që së bashku me Shqipërinë dhe Kroacinë të bëjnë blerje të përbashkëta të armëve amerikane.

Viteve të fundit, Qeveria ka rritur buxhetin për sektorin e mbrojtjes dhe këtë vit buxheti për këtë sektor është 207.8 milionë euro.

KOMISIONI EVROPIAN: 50% E FONDEVE DO TË LIROHEN PËR KOSOVËN

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Komisioni Evropian ka njoftuar se do të lirojë rreth 50 për qind të ndihmës financiare për Kosovën, në vlerë prej afërsisht 216 milionë euro.

Ky vendim i KE-së vjen pas transferimit të qetë dhe të rregullt të qeverisjes lokale në veri, pas zgjedhjeve të fundit lokale të mbajtura në tetor 2025. Një zëdhënës i Komisionit Evropian, ka bërë me dije se ky vendim do të mundësojë nënshkrimin e kontratave për katër projekte të reja dhe nisjen e zbatimit të tyre. “Kjo do të lejojë nënshkrimin e kontratave për 4 projekte, që në total përfaqësojnë 34.6 milionë euro kontribut të Bashkimit Evropian, dhe nisjen e zbatimit të tyre”, thuhet në përgjigje.

Po ashtu, Komisioni Evropian ka paralajmëruar përfundimin e programimit të të gjitha fondeve



të mbetura në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit IPA III për Kosovën, në vlerë prej 181 milionë euro.

Sipas Komisionit, “vendimi financiar i Komisionit për këto fonde pritet të adoptohet në pranverën e vitit 2026, çka do të mundësojë që projektet e para të fillojnë në gjysmën e dytë të

vitit 2026”.

Ky zhvillim vlerësohet si hap i rëndësishëm në mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën, veçanërisht pas zhvillimeve të fundit politike dhe zgjedhore në vend.

Njoftimi i Komisionit Evropian lë të kuptohet se masat nuk do të hiqen në tërësi, siç do të preferonin shumica e shteteve

anëtare të BE-së, por do të zbuten gradualisht, ndërsa nuk jepen detaje konkrete për afatet dhe masat që do të hiqen.

Këtë lajm e ka konfirmuar edhe zëvendëskryeministri i parë për integrim evropian, zhvillim dhe dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, i cili ka treguar se ka pranuar një letër nga drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim të Bashkimit Evropian, Gert Jan Koopman, ku komunikohet se Komisioni ka vendosur për heqjen e shumicës së masave ndaj Kosovës. Bëhet fjalë për projekte të lidhura me programet IPA, në vlerë prej 34.6 milionë euro. “Në vazhdimësi kemi insistuar për heqjen e masave. Mirëpresim hapin e radhës nga ana e BE-së, i cili duhet të vijojë sa më parë me heqje të plotë të tyre. Nuk ka më asnjë arsye që një pjesë e tyre të mbeten në fuqi, sidomos pas transferimit të pushtetit në katër komunat në veri në mënyrë ligjore dhe të qetë”, ka

theksuar Bislimi.

Elmi Reçica nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar se heqja e masave ndëshkuese nga Bashkimi Evropian është lajm i mirë për Kosovën. “Por këto masa nuk erdhën rastësisht, ato ishin pasojë e një qeverisjeje konfrontuese dhe izoluese që e përkeqësoi raportin me aleatët tanë. Përgjegjësinë politike për këtë situatë e mbajnë Albin Kurti dhe Besnik Bislimi. PDK-ja ka qenë e qartë dhe konsistente, Kosova duhet të rikthehet në rrugën e bashkëpunimit, dialogut dhe besimit me BE-në. Bedri Hamza ka dëshmuar se diplomacia aktive funksionon, me veprime konkrete në Bruksel, ai e ka rikthyer Kosovën në rrugën e partneritetit strategjik. Me Kurtin do të ketë izolim dhe regres, ndërsa me Bedri Hamzën, zhvillim, stabilitet dhe marrëdhënie të forta ndërkombëtare”, ka deklaruar Reçica.



TË MËRKURËN KA NISUR ZYRTARISHT FUSHATA PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PARLAMENTARE TË 28 DHJETORIT

ZYRTARISHT NIS FUSHATA ZGJEDHORE, PARTITË ME PREMTIME TË REJA

Të mërkurën ka nisur zyrtarisht fushata për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit, e cila do të zgjasë deri më 28 dhjetor në orën 06:59. Gjatë kësaj periudhe, subjektet politike kanë të drejtë të organizojnë tubime, ngjarje politike, debate, konferenca për media dhe aktivitete të ngjashme. Në hapjen e fushatës zgjedhore, liderët e partive politike kanë dhënë premtime të reja para qytetarëve me rastin e prezantimit të programeve të tyre qeverisëse

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Të mërkurën ka nisur zyrtarisht fushata për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit, e cila do të zgjasë deri më 28 dhjetor në orën 06:59.

Sipas Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, gjatë kësaj periudhe, subjektet politike kanë të drejtë të organizojnë tubime, ngjarje politike, debate, konferenca për media dhe aktivitete të ngjashme. Gjithashtu kanë të drejtë të publikojnë dhe shpërndajnë afishe, reklama dhe materiale të tjera zgjedhore, si dhe të zhvillojnë fushatë përmes televizionit, radios, mediave të shkruara, rrjeteve telefonike, sistemit postar dhe mjeteve të tjera reklamuese, në përputhje me Kodin e Mirësjelljes, rregullat e KQZ-së dhe ligjet në fuqi.

Fletëvotimi për zgjedhjet e 28 dhjetorit përmban 24 subjektet politike pjesëmarrëse në këtë proces zgjedhor, prej të cilave, 18 parti politike, 3 koalicionet, 2 iniciativa qytetare dhe 1 kandidat i pavarur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se tashme ka nisur procesi i dërgimit të pakove me fletëvotime për rreth

58 mijë votuesit e regjistruar jashtë Republikës së Kosovës për votim me postë në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Votimi përmes postës përfundon më 27 dhjetor 2025 dhe KQZ u bën thirrje votuesve që të mos presin ditën e fundit për ta dërguar pakon e tyre me fletëvotim.

KQZ-ja ka marrë vendim për akreditimin e grupit të parë me 283 vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Partitë me premtime të reja për zgjedhjet

Në sallën 1 Tetori, kandidati për kryeministër nga LV-ja, Albin Kurti ka prezantuar programin qeverisës për mandatin e ardhshëm dhe zotimet e reja, që sipas tij, nuk janë thjeshtë fjalë të mira por ide e plane konkrete që do përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në fjalën e tij hyrëse Kurti tha që plani i qeverisjes së ardhshme do të jetë i fokusuar në dy shtylla kryesore dhe vendimtare: Sigurinë dhe Begatinë. “Pa begati nuk ka dinjitet, dhe pa të dyja nuk ka shtet të fortë”, tha ai, teksa

theksoi si një nga arritjet më të rëndësishme të shtetit tonë në vitet e fundit, shtrirjen e sovranitetit në territorin e vendit.

Kryeministri Kurti, theksoi se Qeveria Kurti 3 është “garanca e vetme që ekonomia të vazhdojë të rritet me të njëjtin trend, dhe që paga, pensionet dhe mbështetja për familjet të vazhdojnë dhe të rriten bashkë me të”.

Ai ka premtuar trefishin të pagës minimale, nga 130 në 500 euro, pagë mesatare 1000 euro në sektorin publik, rritje të pensioneve, mbështetje të nënave lehona, punësimin e grave përmes programit “Superpuna për gratë”, ndërtimit të çerdheve si dhe shpërblim të gjysheve kujdestare të nipërve dhe mbesave në vlerë prej 100 euro në muaj ishin zotime që prekin mirëqenien e çdo qytetari të secilës moshë. “Pensionet i kemi gjetur 90 euro dhe i kemi ngritur në 150 euro, dhe do të vazhdojmë t’i rrisim. Shtesat për fëmijë kanë qenë zero, i kemi ngritur në 30 dhe 45 euro dhe do t’i rrisim në 90 euro. Shtesat për nënat lehona kanë

qenë zero, i kemi bërë 170 euro, pastaj 325 euro, dhe do t’i bëjmë 500 euro, sa paga minimale”, është shprehur Kurti.

Kandidati për kryeministër nga LDK-ja, Lumir Abdixhiku, në hapjen e fushatës ka thënë se LDK-ja po hyn në këto zgjedhje me një ekip përfaqësues, të përgatitur dhe të vendosur. “LDK vjen para qytetarëve me ekipin më të mirë që ka vendi sot. Me programin më serioz dhe më të realizueshëm. Me një vizion të qartë për shtetin që funksionon, për ekonominë që zhvillohet dhe për një Kosovë që rikthen besimin, stabilitetin dhe shpresën”, ka thënë ai.

Abdixhiku ka premtuar që mësuesve të Kosovës do t’u ngritet paga 1000 euro. “Ky është një nivel i ri i projektimit të mësuesit kosovar, nga një simbol qendrese në vitet e 90-ta; në simbol force zhvillimore për Republikën sot. 1000 euro pagë për mësuesin, e vendosë këtë kategori fisnike shumë përpara vendeve në rajon”, është shprehur ai.

Ai ka dhënë një premtim edhe për mbështetjen e drejtpërdrejtë të familjeve dhe nënave të reja në Kosovë. Sipas tij, në momentin që lind një fëmijë, çdo nënë do të përfitojë mbështetje financiare prej rreth 2,400 eurosh në vitin e parë të jetës së foshnjës.

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se si kryeministër, angazhimi i tij është i palëkundur: asnjë veteran nuk do të lihet pas dore. Ai ka theksuar se mbështetja për veteranët e UÇK-së, invalidët

Policia me plan për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor

Policia e Kosovës, sikurse në çdo proces zgjedhor, bazuar në ligjet pozitive të vendit dhe autorizimeve si institucion kyç për sigurinë publike, me kohë ka hartuar urdhrin operativ policor dhe ka bërë të gjitha planifikimet e saja policore lidhur me “Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës”, të cilat do të mbahen me datën 28 dhjetor 2025.

Me qëllim që ky plan policor të realizohet sipas planifikimeve të parapara dhe me qëllim të ofrimit të sigurisë e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, është paraparë të angazhohet një numër i mjaftueshëm i

zyrtarëve policorë kryesisht të rendit publik, por sipas nevojës mund të angazhohen edhe zyrtarë policorë të profileve të ndryshme, që iu përkasin njësiteve të ndryshme brenda Policisë së Kosovës.

Plani operativ përfshin katër faza: Periudha parazgjedhore apo përgatitore vlerësuese; Angazhimi në ofrimin e sigurisë gjatë fushatës zgjedhore; Garantimi i sigurisë në fazën kyçe të ditës së zgjedhjeve dita (Z); dhe periudha pas zgjedhjeve që parasheh transportin nën përcjellje dhe siguri të PK-së, të materialit sensitiv e deri në përfundim të procesit.

ÇFARË PRITET NGA SAMITI BE-BALLKANI PERËNDIMOR?

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian mblidhen në Bruksel më 18 dhe 19 dhjetor me një detyrë të vetme: sigurimi i fondeve për Ukrainën për dy vjetët e ardhshëm. Me më shumë shtete, përfshirë Bullgarinë, Maltën dhe Italinë, që po rreshtohen me Brukselin për vënien në pikëpyetje për realizueshmërinë e një kredie për Kievin për reparacione si metodë e preferuar, shumica e përpjekjeve diplomatike këtë javë do të përqendrohen në tentimin për të zgjidhur këtë çështje. Por, një ditë para takimit, më 17 dhjetor, kryeqendra e BE-së është mikpritëse e një samiti tjetër që krejtësisht është lënë në hije nga zhvillimet që lidhen me Ukrainën: udhëheqësit e gjashtë vendeve aspiruese të Ballkanit Perëndimor (Kosova, Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) takohen me homologët e tyre të BE-së në Bruksel. Kosova, në këtë samit, përfaqësohet nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani. Samiti vjetor BE-Ballkani Perëndimor është bërë një lloj formaliteti viteve të fundit, me pak ose aspak rezultate konkrete, dhe ky takim nuk përbën përjashtim. Draft-deklarata e samitit, që e ka parë Radio Evropa e Lirë, dokument që do të miratohet nga udhëheqësit e BE-së, pohon se “e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në bllokun tonë. Zgjerimi është një mundësi reale që duhet shfrytëzuar”. Në realitet, shumica e gjashtë shteteve janë të bllokuar në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE, dhe vetëm Shqipëria dhe Mali i Zi kanë bërë përparim drejt anëtarësimit në bllok. Por, përgatitjet për samitin dhe lëvizjet politike ofrojnë një shembull të qartë se edhe ky përparim është i brishtë. Gjatë vjeshtës, ideja ishte që Mali i Zi do të mbyllte pesë kapituj politikë - një hap i madh për Podgoricën. Kjo ndodhi më 16 dhjetor dhe shteti tani ka mbyllur 12 nga 33 kapituj gjithsej. Draft-konkluzat, të cilat i ka

parë Radio Evropa e Lirë, thonë se deri javën e kaluar Parisi ka kërkuar që të mbylleshin vetëm tre kapituj. Më pas, presidenti i Malit të Zi, Jakov Millatoviq, kishte biseduar përmes telefonit me homologun francez, Emmanuel Macron, për këtë çështje dhe arriti ta binte që të pajtohej për mbylljen e pesë kapitujve. Problemi që kishte Franca nuk kishte të bënte me të vërtetë me Malin e Zi, por më shumë me Serbinë, një aleate e ngushtë politike e Francës, e cila nuk do të hapë asnjë kapitull të anëtarësimit. Beogradi ka ngecur në rrugën evropiane që nga nisja e pushtimit të Ukrainës më 2022, me disa shtete të tjera anëtare të BE-së që nuk janë të kënaqura që shteti nuk po rreshtohet me sanksionet e BE-së ndaj Rusisë dhe se ka bërë përparim të pamjaftueshëm në fushën e sundimit të ligjit. Duke qenë se hapja dhe mbyllja e kapitujve kërkon konsensus të 27 shteteve anëtare, Franca po e përdor një taktikë që është e zakonshme në Bruksel, atë të lidhjes së përparimit të shtetit kandidat (ose mungesës së përparimit) me të një shteti kandidat tjetër. Përderisa Franca u tërhoq nga Mali i Zi, ajo mori atë që donte sa i përket Kosovës. BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Prishtinës më 2023, përfshirë ngrirja e qindra milionave eurove, pasi Kosova njohu rezultatet e zgjedhjeve lokale në veriun e banuar me shumicë serbe, pavarësisht paralajmërimeve nga Brukseli. Përderisa ekziston një pajtim i gjerë se Kosova ka ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për të shtensionuar situatën dhe masat duhet të hiqen gradualisht, Franca ka udhëhequr përpjekjet për të ngadalësuar këtë proces. Nga Presidenca e Kosovës thanë se gjatë samitit, presidentja Osmani do të zhvillojë takime me udhëheqës të institucioneve të BE-së dhe liderët pjesëmarrës dhe tema kyç do të jenë masat. “Heqja e masave ndaj Kosovës dhe ecja përpara në rrugën e integritetit do të zënë prioritet gjatë diskutimeve”, tha Presidenca e



Kosovës. I mbështetur nga Hungaria, Italia, Spanja dhe Sllovakia, Parisi është siguruar që asnjë masë të mos hiqet para zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen në Kosovë më 28 dhjetor. Këto shtete kanë qenë po ashtu instrumentale që Serbia të shmangë sanksionet e BE-së dy vjet më parë, pasi militantët serbë, që dyshohet se janë mbështetur nga Beogradi, sulmuan Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një polic. Në draft-deklaratën, të cilën e ka parë REL-i, përmendet edhe dialogu mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve, që ndërmjetësohet nga Brukseli. Aty thuhet se “mungesa e normalizimit të raporteve mes Prishtinës dhe Beogradit po mban të dy shtetet të bllokuara në rrugën evropiane”. “Të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun e lehtësuar nga BE-ja duhet të zbatohen, veçmas Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit dhe aneksi i saj. Mbështetja nën Reformën për Ballkanin Perëndimor dhe Rritjen është e kushtëzuar me angazhimin konstruktiv të partnerëve dhe përparimin e matshëm dhe rezultate konkrete në normalizimin e raporteve të tyre”, thuhet në dokument. Që nga shtatori i vitit 2023, disa

ditë para sulmit në Banjskë, nuk është mbajtur asnjë rund i nivelit të lartë në Bruksel. Marrëveshja që përmendet në draft-deklaratë është arritur më 2023, pavarësisht se palët nuk e kanë nënshkruar atë. BE-ja e vlerëson se marrëveshja është e detyrueshme për Beogradin dhe Prishtinën dhe vazhdimisht kërkon zbatimin e saj dhe të aneksit. Kjo marrëveshje, me 11 nene, veç tjerash parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t’i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Në draft-deklaratë përmendet edhe Plani i Rritjes i BE-së për Ballkanin Perëndimor në vlerë prej 6 miliardë eurosh, në këmbim të zbatimit të reformave që lidhen me bllokun. Ky plan, sipas BE-së, ka potencial që të përshpejtojë rritjen ekonomike në rajon në dekadën e ardhme, pasi vendet do të marrin këtë shumë parash për reforma dhe investime. “Kjo shumë është shtesë e 29 miliardë eurove që po zbatohen përmes Planit Ekonomik dhe të Investimeve. BE-ja bën thirrje për shfrytëzim

maksimal të mundësive që ofron Plani i Rritjes përmes zbatimit me kohë të reformave”, thuhet në draft-deklaratë. Përtej çështjes së zgjerimit, nuk ka shumë pika të tjera ku BE-ja mund t’i shtyjë përpara në Ballkanin Perëndimor vitin e ardhshëm, përveç integritetit gradual në tregun e BE-së në disa fusha. Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia gjatë këtij viti iu bashkuan Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), që thjeshton dhe redukon transferet bankare në euro. Ideja është që edhe dy shtetet e tjera, Kosova dhe Bosnja, të bashkohen së shpejti. Ngjashëm, qëllimi i Brukselit për vitin 2026 është që të përfshijë të gjithë rajonin në regjimin e tij të telefonisë mobile, që do t’iu mundësojë qytetarëve nga gjashtë republikat të thërrasin, të dërgojnë mesazhe dhe të përdorin internetin duke përdorur tarifat e brendshme të telefonisë të BE-së. Ky do të ishte një hap drejt uljes së tarifave të roamingut mes BE-së dhe shteteve candidate në Ballkanin Perëndimor, që hynë në fuqi më 2023. Ky hap do të pasonte Moldavinë dhe Ukrainën, të cilat do t’i bashkohen zonës së roamingut të BE-së më 1 janar.

dhe familjet e dëshmoreve do të rritet për 50 për qind. Hamza ka thënë se programi dhe vizioni i tij mbështetet në disa shtylla: zhvillim ekonomik, drejtësi të pavarur dhe efikase, arsim dhe shëndetësi bashkëkohore, mbrojtje dhe siguri. “Ne do t’i rrisim pagat dhe pensionet. Do të ketë rritje të pagave 50% mbi pagën aktuale, për mësues e arsimtarë, policë e zjarrfikës, mjekë e ushtarë dhe për të gjithë ata që marrin paga nga buxheti i Republikës së

Kosovës. Do të ndryshojmë shkallën e tatimit për të ardhurat: Të ardhurat deri në 400 euro - zero tatim. 400 deri në 800 euro - vetëm 8%. Mbi 800 euro - 10%. Do ta shfuqizojmë ligjin aktual të tatimit në pronë, që të mos ketë barrë të papërbalueshme mbi qytetarët dhe bizneset”, ka thënë ai, duke shtuar se do të japin bursa - fond prej 30 milion në vit. “Që çdo student të ketë mundësi të shkollohet e të arrijë kapacitetet e veta. Ndërsa universitetet e Kosovës do t’i

lidhim me industrinë, që të prodhojmë kuadro që i nevojiten Kosovës. Për të moshuarit do të ndërtojmë qendra të veçanta kujdesi për ta, në çdo rajon të Kosovës. E për ata me sëmundje kronike - ilaçe falas. Pa barrë financiare”, ka shtuar më tej ai. Kandidati për kryeministër nga AAK-ja, Ramush Haradinaj, ka thënë se kombinimi i lidhshërit të guximshëm e vizionar, lista gjithpërfshirëse dhe programi i zhvillimit ekonomik, janë themeli mbi të cilin është

ndërtuar oferta e Aleancës për këto zgjedhje parlamentare. Sipas tij, AAK-ja parasheh rritje ekonomike vjetore prej 7 për qind, rritje të GDP-së prej 12 në 14 miliardë euro brenda mandatit, rritje të buxhetit prej 3.3 miliardë eurosh, sa ka qenë në vitin 2025, në 4 miliardë për vitin 2026, për të mbërritur në 6.1 miliardë në vitin e fundit të mandatit katërvjeçar. “Kjo politikë buxhetore është garanci e stabilitetit financiar, e rritjes së pensioneve dhe pagave, të cilat që në vitin 2026 do të shënojnë

rritje prej 31 për qind, shprehur në vlera nominale: pagë mesatare prej 1,100 eurosh dhe pension prej 500 eurosh, varësisht nga kategoritë. Pagat dhe pensionet, në kohë reale, do ta ndjekin trajektoren e ngritjes vjetore sipas indeksit të zhvillimit ekonomik dhe inflacionit. Kategoria e investimeve kapitale, si shtyllë e shtimit ekonomik, do të rritet mesatarisht prej 61 për qind në vitin e parë, për të mbërritur në 240 për qind në vitin 2029”, ka thënë Haradinaj.

Policia mbanë ligjërata me nxënësit për rreziqet nga mjetet piroteknike në prag të festave

GJILAN, 17 DHJETOR - Njësia Sektoriale dhe Komunitet të Stacionit Policor në Gjilan në ambientet e shkollës së mesme të ulët “Zija Shemsiu” në Gjilan, kanë realizuar një ligjëratë informuese dhe vetëdijësuese me temën “Pasojat dhe rreziqet nga përdorimi i mjeteve piroteknike”, ligjëratë kjo duke pasur parasysh se ndodhemi në prag të festave të fund vitit, periudhë kjo kur përdorimi i

këtyre mjeteve është më i shpeshtë. Gjatë kësaj ligjërate, nxënësit u informuan në mënyrë të drejtpërdrejtë për rreziqet serioze që paraqet përdorimi i mjeteve piroteknike, veçanërisht nga personat e mitur. U theksuan pasojat e mundshme për shëndetin fizik, u njoftuan për rëndësinë e shmangies së përdorimit të mjeteve piroteknike,

respektimin e ligjit dhe ndjekjen e këshillave të institucioneve të sigurisë, me qëllim të parandalimit të incidenteve dhe pasojave. Kjo ligjëratë kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit te nxënësit, edukimin e tyre për sjellje të përgjegjshme në funksion të krijimit të një ambienti të sigurt e festiv për të gjithë qytetarët gjatë ditëve të festave.



REKTORI I UNIVERSITETI TË PRISHTINËS DHE DREJTORI I QKSTK-së VIZITOJNË UNIVERSITETIN MJEKËSOR TË GRACIT

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës në shtator të vitit 2025 nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Universitetin Mjekësor të Gracit të Austrisë për zhvillimin e mëtejshëm të Qendrës për Kërkime, Simulime dhe Trajnime të Avancuara Kirurgjike dhe Mjekësore të Kosovës (QKSTK) në UP.

Në vizitën e parë pas nënshkrimit të memorandumit mes rektorit të Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, drejtorit të QKSTK-së, prof. Rifat Latifit, rektores së Universitetit Mjekësor të Gracit, prof. Andrea Kurz-it dhe drejtorit të Departamentit të Kirurgjisë



Lars-Peter Kamolz-it, u bisedua për planin aktual të zhvillimit dhe mbështetjes për konsolidimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të QKSTK-së në UP nga institucioni prestigjioz i arsimit të lartë austriak. Sipas memorandumit, mes këtyre partnerëve universitarë e

shkencorë do të ketë bashkëpunim akademik në fushat e trajtimit, kërkimit, zhvillimit të kurrikulës, arsimit të vazhdueshëm pasuniversitar, sigurimit të cilësisë, zhvillimit institucional, shpërndarjes së informatave dhe shkëmbimit të studentëve, profesorëve dhe

personelit. Rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, drejtori i QKSTK-së, prof. Rifat Latifi dhe Lumnije Kqiku-Biblekaj nga Departamenti i Stomatologjisë dhe Shëndetit Oral gjatë këtij takimi me rektoren e Universitetit Mjekësor të Gracit, prof. Andrea Kurz dhe drejtorin e Departamentit të Kirurgjisë Lars-Peter Kamolz, u dakorduan për thellimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimeve të ndërsjella. Planet e bashkëpunimit përfshijnë sigurimin e fondeve për renovimin e QKSTK-së, programe të përbashkëta trajnime, projekte bashkëpunimi e shkëmbimesh të ndërsjella,

transferim njohurish dhe bashkëpunim të ngushtë në përgjithësi. Qëllimi madhor është zhvillimi i qëndrueshëm i strukturave moderne të trajnimit dhe kërkimit kirurgjikal në Kosovë e përtej. Qendra për Kërkime, Simulime dhe Trajnime të Avancuara Kirurgjike dhe Mjekësore të Kosovës në UP që do të ofrojë mbështetje në edukim dhe hulumtim për të gjitha degët kirurgjike dhe do të trajtojë çështje të rëndësishme si diplomacia mjekësore dhe teknologjitë e avancuara, u themelua në korrik të vitit 2025, ndërsa në nëntor të vitit 2025 drejtor i saj u zgjodh kirurgu, mjeku dhe profesori me renome ndërkombëtare, prof. Rifat Latifi.

PËRUROHEN AKSELERATORI I RI DHE BUNKERI NË KLINIKËN E ONKOLOGJISË, INVESTIM PREJ 2.7 MILIONË EURO

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, së bashku me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë përrurimin e Akseleratorit të ri dhe Bunkërit në Klinikën e Onkologjisë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, investim në vlerë të gjithmbarshme prej 2.7 milionë euro. Me këtë rast, Kurti tha se ky është një lajm i gëzueshëm për shërimin e pacientëve dhe për kushte shumë më të mira të punës me pajisjet më moderne të teknologjisë së fundit për mjekët, që me punën e tyre të palodhshme, i trajtojnë me kaq shumë profesionalizëm qytetarët e Republikës tonë dhe jo vetëm, që

kanë këtë sëmundje. “Klinika e Onkologjisë është klinikë shembull në Republikën e Kosovës, por madje edhe në rajonin e Ballkanit. Me këtë rast duhet përmendur, që fillimisht është rritur numri i shtretërve. Kanë qenë vetëm 45 shtretër, tash janë 110 shtretër. Pra, kemi më shumë se dyfishim të numrit të shtretërve. Por arsyeja pse ndodhemi sot këtu, është investimi në këtë bunker me hapësirat përcjellëse, në vlerë të gjithmbarshme prej 2.7 milionë euro, përfundimi i të cilit është bërë në një kohë rekord, për vetëm 5 muaj”, tha Kurti. Akseleratori është në vlerë të gjithmbarshme prej afër 1.6 milionë euro dhe gjithashtu është i pajisur edhe me sistemin e avancuar SIRAD, që mundëson saktësi maksimale për rrezatim,



pra e godet tumorin pa i dëmtuar indet rrotull. Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se brenda një periudhe të shkurtër po montojmë akseleratorin e tretë në këtë klinikë, i cili do t’ju shërbejë të gjithë qytetarëve për trajtimin e tyre me Rreze X dhe në anën tjetër nuk do

të ketë fare më lista të pritjes. Ndërkaq, drejtori i Onkologjisë, Ilir Kurteshi falënderoi kryeministrin Kurti, ministrin Vitia dhe Drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi për investime madhore në këto pesë vitet e fundit në klinikën që ai drejton. Si rezultat ato e kanë vënë Klinikën e Onkologjisë në një

pozitë shumë të mirë në kuptimin e shërbimeve cilësore dhe trajtimit të pacienteve me sëmundje malinje. Ky projekt i përruar sot përfshin akseleratorin e ri në vlerë prej afër 1.6 milionë euro; bunkerin, me sipërfaqe rreth 500 m², sipas kushteve dhe standardeve ndërkombëtare për siguri radiologjike dhe të gjitha punimet përgatitore në kantier, në vlerë 700 mijë euro; dy sistemet për planifikimin e trajtimit në vlerë 200 mijë euro; një sistem për imobilizimin e pacientëve në vlerë 50 mijë euro; një sistem të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike (UPS) në vlerë 20 mijë euro, si dhe një sistem dozometrik për matjen dhe kontrollin e saktë të dozës së rrezatimit, në vlerë 180 mijë euro.

Themelohet Ekipi Mjekësor Geriatrik për kujdesin ndaj të moshuarve

MITROVICË, 17 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faton Peci, me vendimin e tij të dytë, ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kujdesit shëndetësor dhe social, duke

themeluar Ekipin Geriatrik Mobil, një shërbim i ri dhe unik i dedikuar për kujdesin ndaj të moshuarve. Për herë të parë në Mitrovicë, në kuadër të Qendrës së Mjekësisë Familjare, funksionalizohet një ekip

mjekësor geriatrik mobil, i cili do t’u ofrojë shërbime të drejtpërdrejta personave mbi moshën 65 vjeç, veçanërisht atyre që përballen me sëmundje kronike dhe kufizime fizike. Kryetari Peci ka theksuar se ky

ekip mobil do të ofrojë trajtim mjekësor, mbështetje fizike, psikologjike dhe sociale, duke sjellë shërbimet shëndetësore më afër të moshuarve dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. “Mundi i tyre janë rrënjët mbi të cilat qëndron



qyteti, dhe ne ua kemi borxh minimumin, të kujdesemi për

NË KOSOVË VENDOSEN MASA MBROJTËSE PËR NAFTËN

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, tha se ka vendosur marzhë tregtare për produktet e naftës që përdoren për transport. Sipas vendimit, marzha tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë do të jetë deri në 2 centë për litër, ndërsa me pakicë deri në 12 centë për litër. Hajdari tha se vendimi për caktimin e masave mbrojtëse për produkte të naftës që përdoren për transport u mor me qëllim të “mbrojtjes së konsumatorëve dhe konkurrencës së drejtë në tregun

vendor”. “Ky vendim është rezultat i mbikëqyrjes së vazhdueshme të tregut të naftës, përmes evidencave të përditshme të Doganës së Kosovës dhe raporteve nga ana e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, ku është evidentuar se ndryshimet e çmimeve furnizuese nga importi shpesh pasqyrohen në rritje të menjëhershme të çmimeve të shitjes, ndërsa nuk ndodh një reflektim proporcional në ulje kur çmimet furnizuese bien”, shkroi ajo në “Facebook”. Vendimi do të hyjë në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Sipas Hajdarit, parashihet që të



shtohen inspektimet nga Inspektorati i Tregut lidhur me zbatimin e vendimit. Çmimi aktual i naftës me

pakicë është rreth 1.25 euro për litër. Edhe në të kaluarën, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga

Albin Kurti, tashmë kryeministër në detyrë, kishte vendosur masa mbrojtëse për naftën. Më 2023, një vendim i tillë ishte kundërshtuar nga naftëtarët, të cilët kishin argumentuar atëbotë se vendimi ishte marrë bazuar në inspektimin e disa kompanive që “abuzojnë me çmimin e naftës” dhe se vendime të tilla “po dëmtojnë të gjithë sektorin”. Edhe më 2022, Qeveria kishte vendosur masa mbrojtëse për produkte të naftës duke përcaktuar një çmim tavan për shitjen me shumicë dhe pakicë të kësaj lënde.

LANSOHET KËRKESA PËR PROPOZIME PËR ANKANDIN E PARË TË ENERGJISË NGA ERA DERI NË 100 MW

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ministria e Ekonomisë ka publikuar Kërkesën për Propozime (KP) për Ankandin e Parë të Energjisë nga Era në Kosovë për ofrimin e kapacitetit të ri gjenerues deri në 100 MW, që synon të sigurojë deri në 100 MW kapacitet të ri gjenerues nga era në kuadër të një Skeme Mbështetëse 15-vjeçare. Ky hap pason përfundimin me sukses të fazës së Kërkesës për Kualifikim (KK) dhe parakualifikimit të tre ofertuesve, të cilët tani ftohen të dorëzojnë ofertat e tyre teknike dhe financiare në fazën e KP-së: Akuo Energy (Francë); Notus Energy (Gjermani) dhe Stublla

Energy (Kosovë); Konsorciumi Guris (Turqi). Ankandi i energjisë nga era është pjesë e strategjisë së Kosovës për të forcuar sigurinë energjetike duke zgjeruar kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike dhe për të diversifikuar miksën energjetik përmes prokurimit konkurrues dhe të bazuar në treg të energjisë së ripërtëritshme. Duke shfrytëzuar përvojën nga ankandi i parë solar prej 100 MW në Kosovë, Ministria e Ekonomisë mbetet e përkushtuar për administrimin e ankandit të energjisë me erës me të njëjtat standarde të larta të transparencës, drejtësisë dhe

konkurrueshmërisë, duke siguruar që përfituesi përfundimtar i këtij procesi të jenë qytetarët e Republikës së Kosovës. Sipas KP-së, propozimet do të vlerësohen mbi bazën e përputhshmërisë dhe çmimit, ku kontrata do të jepet në bazë të çmimit më të ulët të energjisë elektrike të ofruar (EUR/MWh), i cili nuk duhet të tejkalojë çmimin tavan. Kjo qasje ka për qëllim sigurimin e energjisë së ripërtëritshme me një çmim konkurrues, duke mbajtur procesin të fokusuar te përballueshmëria, krahas energjisë së pastër dhe sigurisë së furnizimit.



Ky projekt është bërë i mundur falë mbështetjes së fortë të partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) si këshilltar i transaksionit, e mbështetur nga Qeveria e Gjermanisë, si dhe Qeveria e

Luksemburgut përmes LuxDev, Agjencisë së Luksemburgut për Bashkëpunim dhe Zhvillim, ndihma e vazhdueshme e së cilës vazhdon të luajë një rol jetësor në avancimin e tranzicionit energjetik të Kosovës.

SUPREMJA ANULON VENDIMIN PËR SHKARKIMIN E KELMENDIT NGA USHTRUESI I DETYRËS SË KRYEPROKUROR TË SHTETIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Gjykata Supreme e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paraqitur nga Besim Kelmendi, u.d Kryeprokurori i Shtetit dhe ka anuluar vendimin KPK.nr.1056/2025, të datës 20 nëntor 2025, si të kundërligjshëm. Lënda i është kthyer Këshillit Prokurorial të Kosovës në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë



Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se ankesa është e bazuar. Meqenëse vendimi mbi shkarkim është marrë bazuar në pretendimet se u.d i kryeprokurorit të shtetit, përmes

deklarimeve në Këshill dhe media ka shprehur qëndrim të njëanshëm, të cilat qëndrime dhe deklarime kanë denigruar pozitën e tij dhe kanë cenuar besimin e sistemit prokurorial dhe të publikut, janë elemente të

përgjegjësisë disiplinore që përfshihen në kuadër të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që vendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe Kodit të Etikës Profesionale për Prokurorë. Sipas Gjykatës Supreme vendimi i atakuar është i kundërligjshëm,

arbitrar dhe i pa bazë, sepse është kontradiktor në vetvete nga fakti se ku mbështetet një vendim i tillë (baza ligjore), dhe kjo krijon pasiguri se si ka mundësi një organ i tillë të merr vendime pa bazë ligjore specifike dhe referuar në dispozita që nuk i japin autorizime të veprave në formën dhe mënyrën se si ka vepruar. Pra është procedurë e pa mbështetur në ligj dhe atë që nga fakti i rendit të ditës, caktimit të të njëjtut, ndryshimit të rendit të ditës, votimit, procedimit, përfundimit, rihapjes apo takimit të ri deri te vendimi i atakuar për shkarkim.

Rama nënshkruan kontratën për investim 6 milionë euro në eficiencë energjetike në 20 ndërtesa publike në kryeqytet

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka nënshkruar kontratën për fillimin e një investimi prej 6 milionë eurosh për rritjen e eficiencës energjetike në 20 ndërtesa

publike në kryeqytet. “Me mbështetjen e BERZH-it dhe Bashkimit Evropian, po investojmë në shkolla, çerdhe dhe Qendra të Mjekësisë Familjare, për kushte më të mira, kursim të energjisë dhe

standarde evropiane. Ky është një hap i rëndësishëm drejt një Kryeqyteti më të qëndrueshëm dhe më të mirë për qytetarët tanë”, ka thënë Rama të mërkurën pas nënshkrimit të kësaj kontrate.



NGA ELEKTRONIKA TEK USHQIMI: KOSOVA SHPENZOI GATI 900 MILIONË EURO PËR MALL KINEZ

Importet nga Kina po rriten në mënyrë të ndjeshme në Kosovë, duke kapur 841 milionë euro për 11 muajt e parë të vitit 2025. Ndikimi i Kinës në Kosovë është kryesisht tregtar - me, siç thuhet, mallra të përballueshme për qytetarët. Kosova mbetet e orientuar strategjikisht nga Perëndimi, pa borxhe ose investime direkte kineze, por rritja e importeve nga Kina ngre sfida për prodhuesit vendorë

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kosova shpenzon mbi dy milionë euro brenda një dite për mallra të importuara nga Kina - nga lodrat dhe pajisjet elektro-shtëpiake deri te produktet ushqimore dhe ato bujqësore.

Të dhënat flasin për një prani gjithnjë e më të madhe të këtyre mallrave në tregun kosovar. Sipas statistikave të Doganës së Kosovës, vlera e importit nga Kina është rritur nga 452 milionë euro në vitin 2021 në 841 milionë euro në 11 muajt e parë të vitit 2025.

Kjo shumë tashmë ka tejkaluar vlerën e importeve nga vendet anëtare të CEFTA-s - Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina dhe Moldavia - të cilat tradicionalisht kanë qenë ndër partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës në rajon.

Në pesë vjetët e fundit, produktet kineze kanë shënuar një rritje të ndjeshme në tregun e Kosovës. Kjo tregon ndikimin gjithnjë e më të madh të Kinës në strukturën e importit të vendit, edhe pse Gjermania dhe Turqia mbajnë ende nivelin më të lartë të importit.

Në anën tjetër, eksportet e Kosovës drejt Kinës mbeten pothuajse simbolike: më pak se një milion euro në vit - çka e thellon ndjeshëm deficitin tregtar dhe e vendos raportin ekonomik mes dy vendeve në një pabarazi të theksuar.

Tregti pa diplomaci

Përkundër këtyre shkëmbimeve tregtare, Prishtina dhe Pekini nuk kanë marrëdhënie diplomatike. Kina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, të shpallur në vitin 2008, dhe vazhdon të mbështesë “integritetin territorial të Serbisë”, e cila, me Kushtetutë, Kosovën e konsideron pjesë të territorit të saj.

Për rrjedhojë, Kina nuk ka ambasadë në Kosovë, por vetëm një zyrë ndërlidhëse që funksionon nën Ambasadën kineze në Beograd.

Pse Kina është kaq e pranishme në tregun kosovar?

Gazmend Qorraj, ligjërues i Tregtisë Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, thotë për Radion Evropa e Lirë se çmimi i ulët i produkteve kineze është faktori kryesor që i bën ato tërheqëse për tregun e Kosovës. E, kjo lidhet drejtpërdrejt edhe me fuqinë e ulët blerëse të

qytetarëve, sipas tij. Qorraj shpjegon se bizneset veprojnë kryesisht të udhëhequra nga logjika e fitimit, pa marrë domosdoshmërisht parasysh implikimet makroekonomike apo strategjike. “Tregtarët investojnë aty ku shohin potencialin më të madh për fitim, pavarësisht nga origjina e mallrave apo produkteve”, shton ai.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi disa kompani që importojnë mallra nga Kina, por shumë pak pranuan të flisnin publikisht. Ramiz Kelmendi udhëheq kompaninë “Elkos Group”, e cila ofron një gamë të gjerë produktesh - nga ushqimet deri te tekstili.

Ai thotë se kjo kompani importon mallra nga Kina në vlerë mbi 12 milionë euro në vit. Megjithatë, sipas tij, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten burimet kryesore të importeve. “Po, çmimi është më i lirë”, thotë Kelmendi, duke shtuar se mungesa e industrisë vendore në sektorë si tekstili dhe elektroteknika, e detyron Kosovën të importojë aty ku produktet janë më të përballueshme.

Vetëm vitin e kaluar, Kosova importoi nga Kina mbi 14.4 milionë euro pajisje elektronike, si: kamera digjitale, televizorë dhe antena, si dhe mbi 13 milionë euro telefona të mençur dhe aparate të tjera telefonike.

Ushqimi nga Kina - shqetësim ekonomik dhe shëndetësor

Megjithatë, ajo që e shqetëson më së shumti profesorin Qorraj është fakti se të dhënat doganore tregojnë se nga Kina po importohen edhe produkte ushqimore dhe bujqësore. “Është veçanërisht problematike kur bëhet fjalë për produktet bujqësore, sepse ato lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e shëndetit publik”, thotë ai. Nga ana ekonomike, Qorraj thekson se importet e tilla dëmtojnë konkurrencën lokale dhe dekurajojnë prodhuesit vendorë, mallrat e të cilëve shpesh janë më të shtrenjta, për shkak të kostove më të larta të prodhimit. Kelmendi e sheh këtë situatë si mungesë të një politike të qartë ekonomike. “Kosova nuk prodhon banane apo ananas, por hudhër po. Qeveria duhet ta stimulojë prodhimin vendor që çmimet të jenë konkurruese”, thotë ai, duke shtuar se importet nga Kina janë jo vetëm të



panevojshme, por edhe joefikase, pasi një dërgesë mund të zgjasë deri në 120 ditë.

Qorraj, gjithashtu, sugjeron masa stimuluese dhe mbrojtëse për prodhuesit vendas, si dhe orientim më të madh drejt tregut të Bashkimit Evropian dhe tregjeve ku Kosova ka qasje preferenciale.

Kina në Ballkanin Perëndimor - ndikim i pabarabartë

Një raport i publikuar në shtator nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), me titull: “Gjurma e Heshtur e Kinës: Hartëzimi i ndikimit kinez në politikën lokale dhe peizazhin ekonomik në Kosovë”, thekson se prania ekonomike e Kinës në Ballkanin Perëndimor është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit. Sipas këtij raporti, rritja e importeve nga Kina është duke krijuar varësi tregtare, përkundër eksporteve minimale, ndërsa angazhimi i bizneseve shpesh udhëhiqet nga fitimi afatshkurtër, me vetëdije të kufizuar për pasojat afatgjate politike dhe të sigurisë. Zyra e Kryeministrit të Kosovës nuk iu

përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë lidhur me rritjen e importeve nga Kina apo mundësinë e masave mbrojtëse për prodhuesit vendorë. Megjithatë, kryeministri Albin Kurti - tani në detyrë - ka deklaruar më herët se, pavarësisht importeve nga Kina, vendet e Bashkimit Evropian mbeten partnerët kyç tregtarë të Kosovës.

Në vitin 2021, Qeveria e Kosovës ka refuzuar ofertën për vaksina kineze kundër sëmundjes Covid-19, duke sinjalizuar qartë atëkohë orientimin politik dhe strategjik drejt Perëndimit.

Serbia si “poligon” i ndikimit kinez

Xhelal Neziri, analist në Institutin Ballkanik për Bashkëpunim Rajonal (BIRC) në Maqedoninë e Veriut, thotë se ndryshe nga Kosova dhe Shqipëria, Serbia shërben si “poligon” për shtrirjen e ndikimit ekonomik dhe politik të Kinës në rajon. Sipas tij, në Kosovë ndikimi kinez mbetet kryesisht tregtar - pa peshë të theksuar politike apo strategjike. “Kosova, ashtu si

edhe Shqipëria, është e rreshtuar plotësisht me politikat e Perëndimit, konkretisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian”, thotë Neziri.

Ndërkaq, në vende të tjera të rajonit - Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut - Kina ka financuar projekte të mëdha infrastrukturore përmes kredive, duke rritur ndikimin ekonomik dhe, në disa raste, politik.

Sipas një analize të Qendrës për Forenzikë Digjitale (DFC) nga Podgorica, Kina ishte investitori i dytë më i madh në Serbi në gjysmën e parë të vitit 2024, pas BE-së. Në Mal të Zi, roli i saj si kreditor dhe kontraktues është i dukshëm, siç tregon edhe kredia prej rreth 900 milionë dollarësh nga banka kineze, Exim, për ndërtimin e një autostrade në fillim të viteve 2020.

Në Bosnje e Hercegovinë, ndikimi kinez është më i dukshëm në entitetin Republika Sërpska, përmes tregtisë, arsimit, mediave dhe diplomacisë, ku bashkëpunimi ekonomik dhe kulturor shpesh ka përmbajtje gjithnjë e më të theksuar politike. Në Maqedoninë e Veriut, borxhi ndaj Kinës arrin në 479 milionë dollarë, ose 8.7 për qind të borxhit të jashtëm.

Në kontrast, Kosova nuk ka borxh ndaj Kinës dhe as investime të drejtpërdrejta kineze. Vitin e kaluar, investimet e huaja direkte në Kosovë arritën në 847 milionë euro, por asnjë prej tyre nuk ishte me origjinë kineze.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk kanë dhënë informacion nëse në Kosovë janë të regjistruara kompani ose organizata joqeveritare me origjinë kineze.

Kina në kontekstin global

Perceptimi i Kinës në botë ka dy dimensione: nga njëra anë, ajo shihet si një superfuqi ekonomike që mund të ofrojë mallra me çmime të ulëta, financime dhe investime infrastrukturore, e, nga ana tjetër, shumë shtete e vlerësojnë me rezervë, për shkak të ndikimit të saj politik dhe rivalitetit gjeopolitik me Perëndimin. Rritja e tregtisë me Kinën shpesh shihet si një mundësi

ekonomike afatshkurtër, por që mund të krijojë varësi dhe rreziqe strategjike në një perspektivë afatgjatë. Në këtë kontekst, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka ndërmarrë një qëndrim më të ashpër ndaj Pekinit, duke e trajtuar atë si rival strategjik dhe ekonomik të ShBA-së, përmes politikave proteksioniste, tarifave tregtare dhe kufizimeve teknologjike.

ZBULIMET E ZONJËS SË AKULLT DHE DRAMAT E UASHINGTONIT



Philip ELLIOTT

Natën kur Donald Trump rimori Presidencën, ai e ftoi menaxheren e fushatës, Susie Wiles, të dilte në podium për të marrë duartrokitjet. Ajo refuzoi.

Kur ekipi i tij u zhvendos në Harvard për një takim dyditor publik mbi fushatën, ndihmësja kryesore e Trump-it qëndroi në Florida.

Dhe kur po përgatitej të hynte në zyrën e saj në Krahun Perëndimor, Wiles e përsëriti disa herë se nuk kishte durim për këdo që kërkonte të bëhej yll. “Unë dhe ekipi im nuk do të tolerojmë thashetheme, dyshime të papërshtatshme apo drama. Këto janë kundërproduktive për misionin,” i tha ajo Axios-it përpara Ditës së Inaugurimit.

E gjitha kjo bie në kontrast të fortë me imazhin e Wiles që doli papritur të martën, pas një serie prej 11 intervistash me një studiues të rolit të shefave të stafit të Shtëpisë së Bardhë, të publikuara nga Vanity Fair. Në to, Wiles flet me një sinqeritet të jashtëzakonshëm, dhe ndoshta pa u kujdes shumë për protokollin, për Trump-in dhe

ekipin që ajo drejton në emër të tij.

Ndërsa Trumpi e ka quajtur “zonja e akullt”, ajo e përshkroi atë si një person me “personalitet alkooliku”, në kuptimin se “vepron me bindjen se nuk ka asgjë që nuk mund ta bëjë”. (Trump, siç dihet, nuk pi alkool.) Dhe ndërsa Trump e ka cilësuar vazhdimisht si “gruan më të fuqishme në botë”, ajo ia ktheu komplimentin duke pranuar se ai gabon, shumë herë.

Për dikë që predikon një moto që do t’i shkonte më shumë ekipit “pa dramë” të Obamës, Wiles i shtoi jo pak erëza gjellës politike të Uashingtonit me këto biseda, herë nga zyra e saj e herë nga lavanderia e shtëpisë. “Nuk e kërkoj kurrë vëmendjen,” tha ajo në një nga intervistat.

Ndoshta. Por zbulimet e saj e hodhën Uashingtonin në lojën e zakonshme të hamendësimeve: sa do të qëndrojë Wiles në detyrë dhe çfarë loje po luan ajo? Në fund të fundit, gjatë katër viteve të para të Trump-it, Shtëpia e Bardhë ndërroi katër shefa stafi, dhe tri fushatat e tij dukeshin vazhdimisht në rindezje, me personalitete

rivale që shfaqeshin si “të parët mes të barabartëve”. Dhe Wiles, një lobiste e zgjuar me bazë në Florida, rrallë bën lëvizje të pamenduara.

Megjithatë, Trumpi kënaqet me këtë lloj drame. Ish-prezantuesi i reality show-ve nuk i ndëshkon njerëzit kur kundërshtojnë axhendën e tij, por kur u atribuohet merita për formësimin e saj. Pikërisht këtu, Wiles mund të ketë fituar pikë: komentet e saj e portretizojnë administratën si të drejtuar nga urdhrat e Trump-it. Edhe kur tregon qëndrim sfidues, ajo mbetet mbi të gjitha zbatuesja e vullnetit të tij, duke vepruar sipas dëshirave të tij edhe kur nuk pajtohet me to.

Për tarifatat, Wiles tha se kishte pasur një mosmarrëveshje të madhe mbi mënyrën e ecjes përpara. Trumpi i shpalli ato gjithsesi.

Për hakmarrjen ndaj kundërshtarëve politikë, ajo tha se kishte një marrëveshje të vagullt që ai do të qetësohej pas rreth 90 ditësh në Shtëpinë e Bardhë. Kjo nuk ndodhi.

Për faljen e 1.500 personave të dënuar për rolin e tyre në sulmin ndaj Kapitolit më 6 janar 2021, ajo tha se ishte

mbivotuar.

Për shpërbërjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), tha thjesht se ishte e tronditur.

Dhe për sagën e vazhdueshme të financierit të diskredituar dhe të dënuar për krime seksuale, Jeffrey Epstein, Wiles tha se Trumpi gabonte kur vazhdonte të pohonte se ish-presidenti Bill Clinton kishte rol në skandal. Ndërkohë, Trumpi përmendet në dosje, pranon Wiles, duke shtuar se nuk ka asgjë të dyshimtë.

Nga ana e saj, Wiles deklaroi të martën se autori, Chris Whipple, kishte nxjerrë deklaratat e saj jashtë kontekstit dhe kishte lënë jashtë vlerësimet pozitive për Trump-in dhe ekipin e tij. Sipas saj, ishte një “artikull sulmues”. Shtëpia e Bardhë këmbënguli se Wiles vazhdon të gëzojë besimin e Trump-it.


Megjithatë, Wiles nuk mohoi asnjë nga citimet e saj, përfshirë cilësimin e zëvendëspresidentit J.D. Vance si një “teoricien konspiracioni” që iu bashkua lëvizjes së Trump-it vetëm nga interesi, sugjerimin se ish-këshilltari i Trump-it, Elon Musk, përdorte mikrodoza ketamine kur

postonte deklarata nxitëse në X, dhe akuzën ndaj prokurores së përgjithshme Pam Bondi se e kishte keqmenaxhuar historinë Epstein.

Këto momente dukshëm të pakontrolluara i dhanë jetë asaj që shumë në Uashington tashmë e dyshonin ose e dinin nga afër. Por Trumpi e urren t’u japë kundërshtarëve një fitore dhe çdo gjë më pak se mbrojtja e Wiles do të binte ndesh me mënyrën e tij të veprimit. Në fund të fundit, kur këshilltari i tij i parë për sigurinë kombëtare këtë mandat u kritikua për dërgimin gabimisht të informacionit të ndjeshëm mbi operacione ushtarake te një gazetar, ai u dërgua në OKB.

Megjithatë, momenti i zbulimit të Wiles ishte një shikëputje e fortë nga imazhi i ndihmësës së heshtur që Trumpi ftoi të fliste natën e fitores në klubin e tij në Florida. “Susie pëlqen të qëndrojë disi në prapaskenë,” tha Trumpi. “Zonja e akullt. Kështu e quajmë.”

Tani, ajo mund ta gjejë veten të lënë në akull, të paktën për një kohë të shkurtër, ndërsa të gjithë përpiqen të kuptojnë sa do të zgjasë shkrirja. / Time – Bota.al



Trepça, lidere e Superligës në basketboll

MITROVICË, 17 DHJETOR - Kampionia në fuqi, Trepça, është liderja e re në Superligën e Kosovës në basketboll. Në palestrën "Minatori", Trepça ka mposhtur Borën e Prishtinës me rezultat bindës 90:72. Kjo ndeshje ishte e mbetur nga xhiroja e pestë e Superligës. Skuadra nga kryeqyteti ishte vendase, por loja është zhvilluar në Mitrovicë.

"Xehëtarët" e kanë vendosur ndeshjen në çerekun e tretë, ku kanë bërë shikëputjen e madhe. Çereku i parë ka përfunduar 21:16 për Borën, ndërsa pas pjesës së parë rezultati ishte 39:36 për Trepçën. Çereku i tretë është mbyllur 38:11 në të mirë të mitrovicasve, duke e vulosur fitoren, ndërsa çereku i katërt ishte më shumë formalitet.

Ja'cori Payne, i ka udhëhequr mitrovicasit me 17 pikë, nëntë asistime dhe katër kërcime, e po ashtu edhe Mikaille Tmushiq po ashtu ka pasur paraqitje të mirë me 14 pikë, pesë kërcime, pesë asistime dhe gjashtë topa të rrëmbyer, ndërsa Drilon Hajrizi ka shënuar 20 pikë. Te Bora është dalluar Shaquan Jules me 25 pikë dhe 11 kërcime, ndërsa

Amin Hot ka kontribuar me 17 pikë, gjashtë kërcime dhe tri asistime. Prishtinasit kishin një seri prej katër fitoreve radhazi, por kësaj radhe nuk kanë pasur gjasa përballë Trepçës. Me këtë fitore, "Xehëtarët", aktualisht kanë tetë fitore dhe tri humbje duke udhëhequr tabelën me 19 pikë. Bashkimi dhe Peja kanë nga 18 pikë, ndërsa Bora me



pesë fitore dhe gjashtë humbje ka 16 pikë dhe renditet në mesin e tabelës. Sot (e enjte) nga ora 18:45, luhen ndeshjet Bashkimi - Golden Eagle Ylli dhe Trepça - Bora.

FIFA: 10 MILIONË EURO SHPËRBLIM PËR KOSOVËN E SHQIPËRINË NËSE KUALIFIKOHEN NË KUPËN E BOTËS

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kombëtarja e Kosovës në futboll dhe Kombëtarja shqiptare, në muajin mars do të luajnë për histori, mundësinë për t'u kualifikuar për Botërorin e vitit 2026, por edhe për milionat. Dardanët dhe Kuqezinjtë do të luajnë për një biletë në Botërorin 2026 me shpresën që të kapërcejnë rivalët në gjysmëfinale, Kosova me Sllovakinë e më pas në finale kundër Rumanisë apo Turqisë dhe Shqipëria kundër Polonisë në gjysmëfinale dhe më pas

fituesen e çiftit Ukrainë-Suedi, për të shkruar emrin për herë të parë në aktivitetin më të rëndësishëm për kombëtare në botë.

Por, paralelisht me prestigjin e kualifikimit, për Kosovën e Shqipërinë do të ketë edhe një premi të majme në lojë. Kjo premi vjen direkt nga FIFA, e cila ka zbuluar se ka rritur shifrën që do t'u paguajë të gjitha skuadrave pjesëmarrëse në Botërorin që zhvillohet në SHBA, Kanada dhe Meksikë.

Këshilli i FIFA-s, i mbledhur në



Doha të Katarit me rastin e finales së Kupës Interkontinentale, ka miratuar një pagesë rekord prej 10 milionë eurosh për çdo ekip i cili merr pjesë në Botërorin 2026.

Kjo është shifra më e lartë e akorduar ndonjëherë për ekipet përfaqësuese në një kampionat të tillë, ku janë rritur edhe shpërblimet për çdo fazë që kalohet në turne, për të arritur deri në 50 milionë euro më shumë që do të përfitojë Kombëtarja, e cila shpallet kampione e botës.

DIPLOMOJNË 31 TRAJNERË NË GJENERATËN E PARË TË PROGRAMIT TË EDUKIMIT "TRAJNER SPORTIV"



Prishtinë, 17 dhjetor - 31 kandidatë të gjeneratës së parë kanë diplomuar në programin e

edukimit "Trajner Sportiv", i cili është organizuar nga Akademia Olimpike e Kosovës (AOK), e cila



vepron në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Të diplomuarit janë përgëzuar nga

sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, si dhe nga udhëheqësit e AOK-ut, Fitim Arifi dhe Diellza

Kelmendi, të cilët njëherit edhe kanë ndarë diplomat.

Akademia Olimpike e Kosovës ofron studime të rregullta në programin e nivelit të pestë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-060, datë 07.11.2008, "Për Kualifikimet Kombëtare". Programi "Trajner Sportiv" është profesion i klasifikuar në Librin e Klasifikimeve të Profesioneve në Kosovë. Ky program synon përgatitjen profesionale të trajnerëve në fushën e sportit, duke i pajisur ata me njohuri dhe kompetenca për trajnim, edukim dhe menaxhim individual dhe grupor në një disiplinë sportive.

Pas Topit të Artë, Dembele rrëmben edhe çmimin e më të mirit nga FIFA

DOHA, 17 DHJETOR - Ylli i Paris Saint-Germain dhe i Francës, Ousmane Dembele, është zgjedhur "Lojtari më i Mirë" për meshkuj nga FIFA për vitin 2025. Sulmuesi francez është shpërblyer pas një sezoni të jashtëzakonshëm me PSG-në. Ai ishte një figurë kyçe gjatë rrugëtimit të klubit drejt

titullit të parë në Ligën e Kampioneve, duke shënuar tetë gola dhe duke dhuruar gjashtë asistime gjatë fushatës triumfuese në Evropë. Dembele, i cili është emëruar MVP i sezonit 2024/25 si në Ligën e Kampioneve ashtu edhe në Ligue 1, ishte thelbësor ndërsa PSG ka fituar

tripletën.

28-vjeçari gjithashtu ka ndihmuar skuadrën të arrinte finalen e parë të Kupës së Botës për Klube. Ndërkohë, në kategorinë e femrave, çmimin si më e mira e vitit e fitoi futbollistja e Barcelonës, Aitana Bonmati. Ndërsa Gianluigi Donnarumma është

shpallur portieri më i mirë i vitit 2025 nga FIFA, duke fituar çmimin prestigjioz "The Best". Kurse trajneri më i mirë është shpallur timonieri i PSG-së, Luis Enrique. Po ashtu, FIFA ka shpallur edhe 11-shen më të mirë për vitin 2025 e cila përbehet nga Gianluigi Donnarumma, Achraf Hakimi,



Willian Pachó, Virgil van Dijk, Nuno Mendes, Pedri, Jude Bellingham, Vitinha, Cole Palmer, Lamine Yamal dhe Ousmane Dembele.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2094/1
Dt: 17.12.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr: 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës në Skenderaj	Skenderaj	Mësimdhënës/ e për lëndët në profilin e Arkitekturës	Zëvendësim	1	6.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHTI;
- Dëshmi të përvojës së punës ne arsim (kontratat e punës ose vërtetim);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit; Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për Arkitekturë

- Msc. i Arkitekturës
- Inxh. i dipl. i Arkitekturës

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.

- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 18.12.2025 deri me 16.01.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2095/1
Dt: 17.12.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr: 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës në Prizren	Prizren	Mësimdhënë/e për Profilin e TIK-ut	Zëvendësim	1	6.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT;
- Dëshmi të përvojës së punës ne arsim (kontratat e punës ose vërtetim);
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit; Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2021, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për Profilin e TIK-ut

Programi i mësimdhënies në teknologji dhe TiK:

- Niveli master arsimore-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Programi i shkencave kompjuterike:

- Niveli master arsimore (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.

- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 18.12.2025 deri me 16.01.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

-Ideal Podrimja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 2273/25
Dt. 17.12.2025

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024, KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESEM TË LARTË PROFESIONAL – MESIMI PËR TË RRRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Q.K. “11 Marsi” në Prizren, shpallim këto drejtime:

	I. Makineri		
1	Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjetllësit	1 Paralele	24 nxënës
2	Automekanik	1 Paralele	24 nxënës
3	Dizajn i Metaleve	1 Paralele	24 nxënës
	II. Ndërtimtari		
1	Arkitekturë	1 Paralele	24 nxënës
2	Ndërtimtari	1 Paralele	24 nxënës
3	Dizajn Enterier	1 Paralele	24 nxënës
	III. Artet e aplikuara		
1	Dizajn Veshje	1 Paralele	24 nxënë
2	Dizajn Grafik	1 Paralele	24 nxënë
	IV. TRANSPORT		
1	Transport Rrugor	1 Paralele	24 nxënës
	V. Elektroteknikë		
1	TIT	1 Paralele	24 nxënës
2	Informatikë	1 Paralele	24 nxënës
3	Instalues Elektrik	1 Paralele	24 nxënës
4	Teknik i sistemeve të IT (TSIT)	1 Paralele	24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimit për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2025/2026, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe qe janë më të vjetër se 18 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHt dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve , bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës QK “11 Marsi” në Prizren, nga ora 10:00-14:00.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nora 2020” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811453472 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nora 2020” D.O.O. Jakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811453472 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nora 2020” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 811453472 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Primalac ponude : Radislav Ivanovic

Predmet: Nikola Ivanovic , Dobrinka Ivanovic , Svetislav Ivanovic
podnosioci ponude za prodaju suvlasnickih idealnih delova .

mi dole potpisani : Nikola Ivanovic sa mojom celokupnim parcelama i idealnim delovima 1/6 , Dobrinka Ivanovic sa svojom celokupnim parcelama i idealnim delovima 1/6 , Svetislav Ivanovic sa mojom celokupnim parcelama i idealnim delovima 1/3 koji samo sa vas suvlasnik sa sve nasim parcelama i idealnim delovima ZK Vrbicane Prizren to smo mi zeljni da prodamao vama sve nase celokupne parcele sa idealnim delovima za ukupnu cenu koja iznosi za 9700 € .

Shodno zakonskim propisima o prodaji nepokretnosti neophodno je da se prodaja ponudi najpre suvlasniku koji ima pravo na prece kupovine pa ako vi odustanete onda se ta prodaja može izvržiti sa drugim licima , pa stoga vam se dostavlja ova ponuda da ako vi ne želite da kupite nase parcele i idealne delove po gore navedenoj ceni odnosno 9700 € eura koji vas mi nudimo da vi kao suvlasnik pošto imate zakonsku prednost za kupovinu da kupite nase celokupne parcele i dealne delove , a ako ne želite onda cemo mi prodati drugom licu –odnosno kupcu koga pronadjemo . Vaše izjasnenje povodom nase ponude je rok 30 dana od dana obaveštanja , te nakon isteka navedenog roka mi cemo pristupiti prodaju drugom licu –odnosno kupcu .

Podnosioci Ponude :
Nikola Ivanovic
Dobrinka Ivanovic
Svetisla Ivanovic

Prizren 17.12.2025 .

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Ego Elsa” Sh.p.k., Llapllasellë, Graçanicë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Qendrën e grumbullimit, ndarjes dhe trajtimit fizik të mbeturinave nga konstruktimi, demolimi dhe mbetrurinave tjera në Objektin Trepça Sh.A. Zona Industriale Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU “Shemsi Ahmeti”, në Shupkovc, Mitrovicë, do të organizohet debat publik nga “Ego Elsa” Sh.p.k., Llapllasellë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/5790165045?pwd=IwFzUaabSwYtu1SQUu2dgctXZpuXv0.1>

Meeting ID: 579 016 5045

Passcode: h9Fwu7


Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Ego Elsa” Sh.p.k., Llapllasellë, Graçanicë - Qendra e grumbullimit, ndarjes dhe trajtimit fizik të mbeturinave nga konstruktimi, demolimi dhe mbetrurinave tjera në Objektin Trepça Sh.A. Zona Industriale Mitrovicë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



100% Fresh & Natural

VIDAS

Llatte drink 2%

TAMËL 2,87

Schmand 18% yndyrë 800g

JOGURT 100% Fresh & Natural

DHALLË 100% Fresh & Natural

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

